

Akt themelimimi dhe Statut
i
Shoqërisë Koncessionare Marina Rodon Sh.p.k.

Në bazë të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me Kontratën e Bashkimit të Përkoħshem tē Shoqërive nr.4367 rep. nr.1718 kol, datë 04.09.2019 lidhur para notere publike Mimoza I. Sadushaj, mes shoqërisë “Praslin Investment” shpk dhe “R&T” shpk si dhe “Kontratë Koncesioni” nr.1188 rep dhe nr.237 kol, datë 30.07.2021 lidhur midis Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkimit tē operatorëve ekonomikë “Praslin Investment” shpk dhe “R&T” shpk para notere Dhurata Vardhami, miratohet ky Akt Themelimi dhe Statuti i Shoqërisë si vijon:

Përkufizime :

Në këtë statut :

- “Statut” është statuti i shoqërisë koncessionare;
- “Koncessionari” ka kuptimin e Bashkimit të Përkoħshem tē Shoqërive “Praslin Investment” shpk dhe “R&T” shpk.
- “Kontrata e Koncesionit” është kontrata e lidhur mes Bashkimit të Përkoħshem tē Shoqërive “Praslin Investment” shpk dhe “R&T” shpk me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë nr.1188 rep dhe nr.237 kol, datë 30.07.2021.
- “Ligji Tregtar” është Ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.
- “QKB” është Qendra Kombëtare e Biznesit.
- “Autoriteti Kontraktor” është Ministrina e Infrastrukturës dhe Energjisë ose një organ tjetër tē tē ardhmen që përfaqëson palën shtet nē kontratën e koncesionit.

KREU 1
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

Themelimi, emri dhe themeluesit

1.1 Sot më datë 25.08.2021, ne, themeluesit kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi tē kufizuar me emrin “Shoqëria Koncessionare “Marina Rodon” sh.p.k.

1.2 Themeluesit e shoqërisë janë :

1. **Shoqëria “Praslin Investment” shpk**, identifikuar me NIPT K52113007F, rregjistruar më datë 20.11.2001, me adresë nē Tiranë rruga Nikolla Tupe, nr.5/9, përfaqësuar sipas Vendimit tē Asamblesë nga dy administratorët Z. Roland Ziu, shtetas shqiptar, i biri i Pilo-s, lindur më datë 26.10.1968, nē Berat dhe banues nē Tiranë rruga Nikolla Tupe, nr.5/10, identifikuar me leternjoftim elektronik G81026092A, person madhor dhe me zotësi tē plotë juridike pér tē vepruar, dhe zoti Elton Bojaxhi, i biri i Aleko, lindur nē Berat më datë 20.09.1982, banues nē Tiranë nē adresën rruga “Bill Clinton”, identifikuar me leternjoftim

1 | Faqe Akt themelimi dhe Statut i “Shoqëria Koncessionare Marina Rodon” shpk

elektronik I20920071K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

2 **Shoqëria “R & T” sh.p.k.**, regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë me Vendim nr. 12590 datë 23.10.1995, me seli në Tiranë, Rruga “Luigj Gurakuqi”, Pallati 89, Shkalla A, Kati 10, me NUIS J61901094G, përfaqësuar sipas Vendimit të Asamblesë nga Z. Renis Tërshana, i biri i Agim, lindur më 23.09.1971, me adresë Rruga “Luigj Gurakuqi”, Pallati 89, Shkalla A, Kati 10, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga karta e identitetit (ID) me numër H10923040R dhe numër personal 02788782I.

2.1 Shoqëria fiton personalitet juridik nga data e rregjistrimit në QKB.

Neni 2

Objekti i veprimtarisë

1.1 Shoqëria Koncessionare Marina Rodon sh.p.k. është subjekt me qëllim të veçantë dhe ka për objekt të veprimtarisë zbatimin dhe përbushjen e kushteve të Kontratës së Koncessionit lidhur me konkurimin publik për kontratën “Dhënie me koncesion/PPP të portit të jahteve “Marina Rodon”, të lidhur me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Enerjisë, për “Ndërtim, financim; operim dhe transferim i Portit Turistik “Marina Rodoni” dhe aktiviteteve të tjera ndihmëse”.”

1.2 Shoqëria koncesionare e ushtron aktivitetin në përputhje me aktin e themelimit, statutin dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

1.3 Në asnjë rast veprimtaria e shoqërisë nuk do të bjerë ndesh me kontratën e koncesionit dhe detyrimet që burojnë nga ajo.

1.4 Shoqëria koncesionare “Marina Rodon” sh.p.k. do të marrë përsipër të gjitha detyrimet sipas kontratës së koncesionit dhe dokumentacionit të konkurimit.

Neni 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë

2.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitet me afat deri në përfundimin e qëllimit të kontratës së koncesionit për të cilën është krijuar.

Neni 4

Selia e Shoqërisë

3.1. Selia e Shoqërisë është në adresën rruga “Nikolla Tupe”, nr.5, kati 10, njësia administrative nr.5, Bashkia Tiranë.

3.2. Shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi në vende të tjera brenda ose jashtë territorit të Republikës.

3.3 Shoqëria pas ndërtimit do të përcaktojë si seli zyrat në portin “Marina Rodon”.

Neni 5

Vula e shoqërisë

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

Vula do të keto të dhëna : “Shoqëria Koncessionare Marina Rodon shpk”, NUIS dhe adresën e selisë së shoqërisë.

KREU 2 KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

5.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 1 000 000 (njëmillion) lek. Secili ortak gjëzon kuotën e tij në shoqëri në përpjestim me kontributin e dhënë në kapital. Pjesëmarrja është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtëme:

a) Ortaku themelues "Praslin Investment" shpk zotëron një kuotë me vlerë 700 000 (shtatëqind mijë) lek, e cila përbën 70 % të kapitalit themeltar.

b) Ortaku themelues "R&T" shpk shpk zotëron një kuotë me vlerë 30 000 (tridhjetë mijë) lek, e cila përbën 30 % të kapitalit themeltar.

Kapitali fillestar i Shoqërisë mund të zmadhohet apo zvogëlohet dhe është tërësisht i likuidueshëm dhe i nënshkrueshëm.

5.2 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet në çdo kohë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast të një zmadhimi të kapitalit, Asambleja do të ketë të drejtën të nënshkruej zmadhimin e kapitalit.

5.3. Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast, kapitali nuk do të reduktohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.

5.4. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali fillestar i saj, nga pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe nga pasuri të tjera të konsideruara ose që do të konsiderohen si të nevojshme për zhvillimin e veprimitarisë së Shoqërisë.

5.5. Kapitali fillestar është nënshkruar tërësisht nga Ortakët.

5.6. Çdo kuotë jep të drejtën e një vote në vlerën e kuotës.

Neni 7

Transferimi i Kuotave dhe rregjistri i ortakëve

6.1. Transferimi i kuotave është i vlefshëm në një nga format e parashikuara nga legjislacioni shqiptar (shitje, dhurim, trashëgimni etj.) dhe vetëm nëse janë respektuar dispozitat e Statutit dhe Kontratës së Koncesionit. Kuotat janë lirisht të transferueshme vetëm midis ortakëve të shoqërisë.

6.2. Në rast transferimi të kuotave midis të gjallëve me akt, ortakëve i takon e drejta e parablerjes të kuotave të shoqërisë. Ortaku shitës si fillim duhet t'i bëjë një ofertë ortakëve të tjerë në të cilën të përcaktojë çmimin e kërkuar për shitjen e kuotës së tij. Në këtë rast secili nga ortakët, në proporcion me pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë, gjëzon të drejtën e parablerjes.

6.3. Në rast mosmarrëveshjesh mbi çmimin e kërkuar, me kërkësë të palëve të interesuara, çmimi do të përcaktohet nga një ekspert kontabël i miratuar me shumicë të thjeshtë nga Asambleja e Ortakëve, i cili do të përcaktojë çmimin e shitjes në bazë të vlerës reale të kuotave.

6.4. Eksperti duhet të kryejë vlerësimet sipas kritereve dhe mënyrave të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

6.5. Pas vlerësimit të kuotave nga ana e ekspertit, si shitësi ashtu edhe blerësi, kanë të drejtë të tërhiqen përkatësisht nga shitja dhe blerja. Në këtë rast shpenzimet e ekspertit do të jenë në ngarkim të palës që tërhiqet.

6.6. Ortaku shitës duhet t'i transferojë kuotën me akt të shkruar ortakëve blerës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit dhe në rast të vlerësimit të bërë nga eksperti kontabël, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e vlerësimit.

6.7. E drejta e parablerjes duhet të ushtrohet brenda një periudhe 30 (tridhjetë) ditore duke filluar nga data e njoftimit të ofertës ose brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e përcaktimit të çmimit nga ana e ekspertit kontabël të emëruar. Pasi kanë kaluar afatet e mësipërme, shitësi ka të drejtën të transferoje tek palë të treta kuotën e tij.

6.8. Në çdo rast, kalimi i kuotave kërkon shprehjen e vullnetit të të gjithë ortakëve, dhe respektimin e kushteve të Kontratës së Koncessionit.

6.9. Shoqëria mban "Rregjistrin e Ortakëve" ku rregjistrohet pronësia mbi kuotat. Rregjistri përmban jo më pak se informacionin si vijon : (i) të dhënat e pronarit të kuotës (ii) aktin e fitimit të pronësisë, (iii) ditën e fitimit të pronësisë.

KREU 3 **Organet e shoqërisë, administrimi**

Neni 8 **Organet e shoqërisë**

Organet e shoqërisë janë

1. Asambleja e Ortakëve – organ vendimarrës,
2. Administratorët - organ ekzekutiv.

Neni 9 **Organi vendimarrës**

8.1. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

8.2. Bëjnë pjesë në detyrat dhe kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të gjitha ato që janë parashikuar e rregulluar me ligj, si dhe të listuar në ketë Statut. Ndër këto detyra përfshihen:

1. Përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë dhe mbikqyrja e zbatimit;
2. Ndryshimi i statutit;
3. Emërimi dhe lirimi i administratorit/administratorëve; Emërimi dhe lirimi i ekspertëve kontabël të autorizuar dhe i likujduesve nëse do jetë e nevojshme; përcaktimi i pagesave dhe shpërblimeve;
4. Miratimi i buxhetit vjetor, të raporteve të administrimit, të inventarit, të bilancit dhe llogarive vjetore;
5. Miratimi i marjes së huave/kredive dhe dhënia e garancive;
6. Miratimi i çmimeve/tarifave për shërbimet që kryen Shoqëria;
7. Përcaktimi i formës së vulës dhe të markës së Shoqërisë;
8. Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë;

9. Ndryshimi i selisë, krijimi ose mbyllja e degëve, zyrave të përfaqësimit ose agjencive të Shoqërisë;
10. Riorganizimimi dhe prishja e Shoqërisë;
11. Vendimi për ndarjen e kuotave dhe për anulimin tyre;
12. Vendimi për miratimin dhe ndryshimin e procedurës për mbledhjen e asamblesë;
13. Marrjen e çdo vendimi tjetër që sipas ligjit i përket asamblesë.

Neni 10

Procedura e mbledhjes së asamblesë

- 9.1. Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit.
- 9.2. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar nga administratori me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike në adresat zyrtare të njoftuara nga ortakët dhe të rregjistruesa në bazën e të dhënave të Shoqërisë. Nëse shoqëria administratohet nga 2 ose më shumë administratorë, mbledhja mund të thirret edhe prej secili prej tyre.
- 9.3. Njoftimi për mbledhjen e asamblesë duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet t'u dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendarike përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 9.4. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas modalitetit të lartpërmendur, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë ortakët janë prezent në mbledhje dhe janë dakord për marrjen e vendimeve, pavarësisht nga mungesa e njoftimit.
- 9.5. Vendimet e asamblesë së përgjithshme merren në formën e vendimeve me shkrim. Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbale. Prosesverbalit duhet të mbajë datën, vendin, rendin e ditës, emrin e Kryetarit të mbledhjes dhe Sekretarit që mban procesverbalin, i cili mund të jetë edhe jo ortak apo jo punëmarrës i Shoqërisë, rezultati i votimit dhe duhet të nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari. Prosesverbalit i bashkëlidhet lista e të pranishmëve dhe thirrja.
- 9.6. Pjesëmarrija apo votimi në Asamblenë e Përgjithshme mund të kryhet edhe nëpërmjet mjeteve elektronike në mënyrën e parashikuara në ligj. Prosesverbalit i vendimeve duhet t'i dorëzohet administratorit/administratorëve, dhe regjistrohet në regjistrin e vendimeve, që do të ruhet në selinë e Shoqërisë nën kujdesin e administratorit/administratorëve.
- 9.7. Asambleja përveç rasteve përjashtimore të parashikuara në këtë statut dhe në Ligjin Tregtar, vendos me votën pro të shumicës së ortakëve prezent në mbledhje.
- 9.8. Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë të kualifikuar të gjithë ortakëve të shoqërisë, për çështjet si vijon:
 - a) Ndryshimet e Statutit;
 - b) Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit;
 - c) Shpërndarja e fitimeve;
 - ç) Riorganizimi, prishja dhe likuidimi i Shoqërisë dhe degëve të saj.
 - d) Shitia e aseteve të shoqërisë, dhënia e huave për subjekte të treta ose ortakët e shoqërisë;
 - dh) Marrja e huave dhe dhënia e garancive në emër të shoqërisë.

Neni 11

Administrimi i shoqërisë

10.1. Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë që emërohen për një afat 5 (pesë) vjeçar duke filluar nga data e emërimit, me të drejtë riemërimi.

10.2. Administratorët e Shoqërisë i ushtrojnë kompetencat e tyre në mënyrë të pavarur (me firma të ndara) nga njëri tjetri për kryerjen e veprimtarive të administrimit te zakonshëm të Shoqërisë, duke aplikuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Për cdo veprim administrimi, administratori njofton administratorët e tjera me postë elektronike.

10.3. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të lirojë administratorin para mbarimit të mandatit. Administratori ka të drejtë të japë dorëheqjen përpara mbarimit te mandatit, me njoftim drejtar Asamblesë së Përgjithshme sipas procedurave të parashikuar në ligj.

10.4. Administratori i parë i Shoqërisë është:

1. **Roland Ziu**, shtetas shqiptar, shtetas shqiptar, i biri i Pilo-s, lindur më datë 26.10.1968, në Berat dhe banues në Tiranë rruga Nikolla Tupe, nr.5/10, identifikuar me letërnjoftim elektronik G81026092A, me zotësi të plotë për të vepruar;

Neni 12

11.1. Administratori/administratorët kryejnë detyrat e përcaktuara nga Asambleja e shoqërisë dhe në këtë Statut dhe të gjitha ato detyra të parashikuara dhe të rregulluara me ligj. Administratorët detyrohen :

1. Të veprojnë dhe të nënshkruajë në emër të Shoqërisë dhe të përfaqësojnë shoqërinë.

2. Të hartoje rregulloren e brendshme të Shoqërisë dhe një plan biznesi për vitin finanziar pasardhës, që do të miratohet në Asamblenë e Përgjithshme.

3. Të përpunojë dhe të paraqesë për miratim në asamblenë e përgjithshme raporte për seurinë e aktivitetit të shoqërisë dhe të bilancit të mylljes së aktivitetit finanziar të vitit paraardhës, sipas asaj që parashikohet në ligj.

4. Të mbajë në rregull regjistrin e vendimeve të asamblesë së përgjithshme.

5. Administratorët janë përgjegjës kundrejt shoqërisë dhe të tretëve për shkeljet e ligjit apo të normave të statutit që mund të ndodhin gjatë seurisë së aktivitetit, sipas legjislacionit shqiptar.

6. Të kryejë të gjitha aktivitetet e administrimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë, duke aplikuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme.

7. Të kujdeset për mbajtjen e dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë me korrekësni dhe saktësi.

8. Të kryejë regjistimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

9. Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

10. Të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rendësi të veçante për veprimtarinë e Shoqërisë.

11. Të emërojnë financierë e konsulentë për problemet e shoqërisë.

12. Të mirë administrojë Shoqërinë.
 13. Të lidhë marrëveshje me të tretë në kufijtë e objektit të aktivitetit të Shoqërisë dhe të kompetencave të përcaktuara nga ortakët.
 14. Të zbatojë rregulloren e brendshme të Shoqërisë.
 15. Të jetë përgjegjës për dëmet e shkaktuara Shoqërisë nga veprimet e tij.
 16. Të informohet dhe të bëjë propozime për çfarëdolloj gjëje që e vlerëson si të rendësishme për shoqërinë.
 17. Të kryejë pagesa për tatime, tarifa dhe pagesa që lidhen për interesat dhe principalin për bankat ku shoqëria ka kredi.
 18. Të kryyejnë çdo veprim që lidhet me përbushjen e detyrime nga Kontrata e Koncesionit.
 19. Cdo veprim të parashikuar nga statuti ose që është pjesë e veprimtarisë së administrimit të shoqërisë, veprim që nuk i është dhënë shprehimisht asamblesë ose që është parashikuar të kryhet bashkërisht nga administratorët.
- 11.2. Nëse shoqëria administrohet nga dy administratorë vetëm veprimet e mëposhtëme do të kryhen me dy firma dhe bashkërisht :
- a) Hapja e numërave të llogarisë në çdo bankë dhe mbyllja e numërave të llogarisë, aplikimi dhe marrja e shërbimit e-banking dhe modifikimi i të dhënave në shërbimin e-banking dhe mbyllja e shërbimit;
 - b) Thirrjen e mbledhjes së asamblesë për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë;
 - c) çdo veprim që lidhet me marrjen e kredive/huave apo dhëni e garancive nga shoqëria;
- 11.3. Administratorët e shoqërisë kanë detyrim të përdorin adresë elektronike sipas vendimit të asamblesë, vendimi depozitohet dhe në QKB si e dhënë vullnetare.

KREU 3 **AKTIVITETI EKONOMIKO – FINANCIAR**

Neni 13

Fitimet e Shoqërisë

- 12.1. Fitimet e Shoqërisë ndahen sipas parashikimeve ligjore.
- 12.2. Asambleja vendos sipas ligjit për ndarjen ose ri qarkullimin e tyre, duke përcaktuar edhe mënyrat.
- 12.3. Nga fitimet e realizuara gjatë vitit finanziar, Shoqëria, pasi bën zbritjen e humbjeve të vitit të mëparshëm, krijon dhe mban fondin “Rezervë e domosdoshme”, dhe repskton çdo detyrim tjetër ligjor.

Neni 14

Shoqëria do të përdorë dhe disponojë pasurinë e saj të akumuluar. Ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera, materiale ose jo materiale, duke përfshirë edhe të drejtën për shitjen e pasurisë së akumuluar tek të tretët. Në Republikën e Shqipërisë, Shoqëria gjëzon të drejta sikundër çdo person/tjetër juridik shqiptar ose i huaj, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 15

Shoqëria vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejtat e detyrimet vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortaku mbart rrezikun e veprimitarës së shoqërisë, vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në të.

Neni 16

E gjithë veprimitaria e shoqërisë për plotësimin e objektit të veprimitarës së saj, pasqyrohet në bilancin ekonomik të saj.

Neni 17

Në selinë e shoqërisë mbahet dokumentacioni financiar, në bazë të cilit, brenda datës 31 mars të çdo viti nxirret bilanci vjetor i Shoqërisë.

Neni 18

Viti financiar fillon çdo vit më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të të njëjtë vit.

Përjashtimisht, viti financiar i parë fillon nga data e rregjistrimit deri në datë 31 dhjetor.

Neni 19

Shoqëria mban llogarinë e saj në Bankë. Llogaritë mbahen në Lekë, Euro dhe/ose dollar amerikan dhe pasqyrohen në librat kontabël përkatës.

Neni 20

Shndërrimi

Shndërrimi i Shoqërisë në shoqëri të llojeve të tjera, mund të behët me vendim të ortakeve themelues sipas mënyrave të parashikuara në ligj.



Neni 21

Prishja e Shoqërisë

21.1 Prishja e shoqërisë, mund te vije për shkaqet e parashikuara ne nenin 99 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 dhe për arsyet si me poshtë:

1. kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
2. me vendim të asamblesë së përgjithshme;
3. me hapjen e procedurave të falimentimit;
4. nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimitarës në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
5. me vendim të gjykatës;
6. humbja e kapitalit te shoqërisë;

21.2. Ne këto raste, ortaket e shoqërisë vendosin mbi mënyrën e likuidimit dhe caktojnë një ose me shume likuidatorë duke u përcaktuar edhe detyrat. Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë se Shoqërisë deri sa ajo t'u dorëzohet personave përkatës fizike e juridike, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet qe ka shoqëria ndaj personave të tretë.



21.3. Në rast se fondet e disponueshme, rezultojnë të pa mjaftueshëm, për shlyerjen e detyrimeve te Shoqërisë, likuidatori mund t'i kërkoje ortakeve themelues të Shoqërisë që të derdhë tërësisht kuotat që u takojnë.

KREU IV TË NDRYSHME

Neni 22

Ligji i aplikueshëm dhe Juridiksoni

- 22.1. Të gjitha konfliktet që mund të lindin midis ortakëve të Shoqërisë, midis ortakëve dhe Shoqërisë, midis Shoqërisë dhe administratorit do ti nënshtronen për zgjidhje gjykatës kompetente të Republikës se Shqipërisë në përputhje me ligjet shqiptare në fuqi.
- 22.2. Për sa nuk parashikohet në Statut, legjislacioni i aplikueshëm është legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 23

Ky statut përpilohet ne 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet në çdo faqe nga ortakët themelues pa vërejtje.

Nënshkruar në Tiranë më datë 25 gusht 2021

Ortaku i Shoqërisë “Praslin Investment” shpk
Roland Ziu Elton Bojaxhi

Ortaku i Shoqërisë “R&T” shpk



Renata Tershanaj

